



Të dashur prindër!

Për pak ditë, më 31 gusht, do të fillojë viti i ri shkollor dhe tashmë e dimë se do të jetë fillimi më i pazakontë i një viti shkollor shumë të pazakontë. Këtë na e solli Pandemia me Covid 19.

Ne, mësimitdhënësit e "Gjimnazit- Loyola", poashtu, nuk kishim pushime të zakonshme verore, për shkak të përgatitjeve të fillimit të vitit shkollor në rrethanat e krijuara. Ne kemi planifikuar të organizojmë mësimitdhënien në shkollë, por normalisht në kushte të reja.

Viti shkollor që lam pas ishte një sfidë për të gjithë, të dashur prindër, sfidë e cila nuk është parë e përjetuar kurrë më parë. Ne u detyruam të orgaizojmë mësimitdhënien online dhe falë ndihmës së pakursyer edhe nga ju, arritëm t'i mbajmë fëmijët tuaj e nxënësit tanë të lidhur me mësimet e tyre. Kështu arritëm të mos e lëmë të dështojë viti shkollor. E gjithë kjo u bë për hir të së ardhmes së fëmijëve. Kjo ishte e qartë për neve që nga shpallja e Pandemisë botërore me Covid 19. Gjetja e rrugëve dhe e alternativave të reja, na mundësoi shpënie përpara të misionit tonë të mësimitdhënies. Çdo gjë tjetër do të ishte e papërgjegjshme dhe një krim kundër nxënësve dhe shoqërisë. Por, të dashur prindër, mund të ketë sukses vetëm nëse të gjithë angazhohemi së bashku. Kjo kërkon veçanërisht mbështetjen tuaj, të cilën, në këtë rast do të dëshiroja ta kërkoj edhe nga ju. Pas një kohe të gjatë dhe një mudi të gjatë, ne kemi hartuar një plan higjienik që është krijuar për të mbrojtur sa më shumë fëmijët tuaj, juve, ne dhe të afërmit tuaj. Këtë plan e gjeni bashkangjitur me letrën tonë. Ju inkurajoni dhe t'i inkurajoni edhe fëmijët tuaj që t'i përmbahen me përpikmëri këtij plani. Masat e parapara për mbrojtjen nga Covid 19, nuk do të dëshironim dhe nuk do të lejojmë të shken. Mbi të gjitha, bëhet fjalë për shëndetin e të gjithë neve.

T'i kthehemi fillimit të vitit shkollor, i cili po na troket në derë! Ne kemi planifikuar një mësimitdhënie të kombinuar, dhe shumica e orëve mësimore do të jenë me prani në shkollë. Mësimitdhënia do të jetë në grupe të vogla dhe në orare të caktuara mësimore, ndërsa për të ruajtur kontinuitetin të të gjithë nxënësit do të kemi edhe disa orë të mësimit online. Ky mësim i kombinuar, poashtu është sfidë në vete dhe kërkon shumë disiplinë, nga të gjithë ne. Ju lutemi të tregoheni të durueshëm dhe bashkëpunues me kolegët tanë, mësimitdhënësit e fëmijëve tuaj. Sidoqoftë, është thelbësore të sigurohet mundësia që fëmijët tuaj ta përdorin drejt kohën për të mësuar në shtëpi. Ne, që nga e hëna do t'ju njoftojmë, përmes fëmijëve tuaj, për orarin e ri të mësimit.

Që nga e hëna nga djemtë e vajzat tuaja, pritet të kryhen detyra dhe mësimet që u caktohen nga mësimitdhënësit e tyre, krahas detyrave të shtëpisë. Këto obligime duhet të kryhen në mënyrë të pavarur. Kopjimi ose heqja dorë nga këto përgjegjësi, jo vetëm që është e dëmshme por edhe e parandalon suksesin e të mësuarit. Mbështetni fëmijët tuaj, për shembull, duke i pyetur ata për mësimet e reja që kanë nxënë. Sigurisht, kjo kërkon kohë, por është një ndihmë e shkëlqyeshme për fëmijët tuaj dhe dëshmi e përpjekjeve tuaja.

Inkurajoni djalin/vajzën tuaj, të kërkojë këshilla nga mësimitdhënësi i lëndës, nëse përkundër përpjekjeve tuaja më të mira, ata nuk ia dalin. Ne mësimitdhënësit dëshirojmë të ndihmojmë kur shohim që nxënësi bën përpjekje. Në fund të fundit, sukcesi i nxënësit është gjithashtu edhe sukcesi i yni.

Të dashur prindër, ne nuk guxojmë ta rrezikojmë të ardhmen e fëmijëve tanë. Viti i ri shkollor që po na pret, duhet të jetë një vit i suksesshëm, përkundër të gjitha vështërsive. Së bashku do t'ia dalim.

Të gjithë neve, ky angazhim, do të na shkaktojë mundime, përpjekje e djersë. Të jemi të bindur se vetëm përmes këtyre përpjekjeve të parreshtura, mund të presim dhe të llogarisim se do të arrijmë deri te sukcesi i përbashkët dhe pastaj të krenohemi me të arriturat tona.

Të dashur prindër, dëshiroj t'ju falënderoj paraprakisht për ndihmën tuaj. Ne, së bashku mund t'i kapërcejmë vështirësitë që po na presin, për shkak të pandemisë. Së bashku do të sigurojmë të ardhme të sigurtë të fëmijëve që na i keni besuar. Jo vetëm që duam por edhe kemi besim të madh se do të arrijmë sukseste në formësimin e drejtë të personalitetit të nxënësve tanë. Le ta bëjmë së bashku!

Ju përsëndes ngruhtësisht edhe në emër të prof. Veli Gashit, prof. Lulzim Tytyxhiut, m. Lindita Spaqit dhe të gjithë kolegëve tanë në ALG!

I juaji prof. Neki Jahaj